

# UDHËZUES PËR GRANTE

Projekti: I SEE – Improved Self-Employment and Employment



## Hyrje

Kosova-Women 4 Women në kuadër të projektit “Mundësitë e përmirësuara të vetë-punësimit dhe punësimit” I SEE që financohet nga Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA) me fondet e Kooperatës Austriake për Zhvillim (ADC), parasheh që për bizneset e grave të ndajë grante me shumë deri në 3,500.00 EUR. Këto grante do të ndahen në formë të bashkëfinancimit me 20% pjesëmarrje të biznesit. Poashtu, përfitueset e grantit do të përfitojnë edhe nga këshillimet rreth biznesit që iu ofron projekti.

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i pozitës së grave në ekonomi dhe në tregun e punës në rajonin e Prishtinës dhe Ferizajt që përfshinë komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Drenas, Gracanicë, Lipjan, Novobërdos, Obiliq, Podujev, Ferizaj, Hani i Elezit, Kacanik, Shtërpçë dhe Shtime.

Ndër të tjera, projekti do të mundohet të akomodojë nevojën dhe kërkesën për trajnime profesionale të akredituara në sektorët ku ka potencial për punësim si mënyrë për të përputhë kërkesën me ofertën dhe të kontribuojë në ruajtjen e punës duke ofruar trajnime profesionale.

## Qëllimi

Projekti ka paraparë të sigurojë grante të drejtpërdrejta për zhvillimin e bizneseve ekzistuese të grave në Kosovë. Qëllimi përfundimtar i projektit është të rritet punësimi dhe vetëpunësimi i grave në mënyrë që të përmirësohet pozicioni i grave në ekonomi dhe zhvillimi i përgjithshëm ekonomik në Kosovë.

## Objektiva

Synimi i përgjithshëm i skemës së granteve është që të përkrahë gratë në biznes me potencial për krijim të punësimi dhe vetëpunësimi të grave me theks të veçantë bizneset në sektorin e bujqësisë (hortikulture, bletari, perpunim i qumshetit, blegtori etj), perpunim të ushqimit, prodhim (rrobaqepesi, artizanate etj.) shërbime.

## Objektivat specifike janë

- Mbështetje për bizneset e grave;
- Krijimi i bizneseve të qëndrueshme;
- Përmirësimi i pozitës së grave në tregun e punës; dhe
- Përmirësimi/zhvillimi i produkteve, proceseve dhe shërbimeve ekzistuese/të reja,

## Kush mund të aplikojë:

- Bizneset e vogla në pronësi ose bashkëpronësi të grave (1 deri 9 punëtor);
- Kooperativat dhe shoqatat e grave;
- Bizneset që veprojnë në komunat e rajonit të Prishtinës dhe Ferizajt (Podujeva, Prishtina, Fushë Kosova, Graçanica, Novobërda, Obiliqi, Lipjani, Drenasi, Ferizaj, Kacanik, Hani i Elezit, Shtërpce);
- Biznese të regjistruara me posedim të fletëregjistrimit;
- Bizneset me posedim të certifikatës të numrit fiskal;
- Bizneset e ndërgjegjshme ndaj ambientit; dhe
- Bizneset që nuk janë nën falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor.
- Bizneset duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë me bashkefinancim prej 20%

## Ndarja e granteve:

### Madhësia e grantit:

Shuma e përgjithshme e vënë në dispozicion në këtë thirrje është 70,000 EUR ndërsa vlera maksimale e grantit është 3,500 EUR me bashkefinancim prej 20% të propozimit nga vetë biznesi. Aplikantët nuk mund të paraqesin më shumë se një aplikim. Kosova - Women 4 Women e rezervon të drejtën që të mos shpërndajë të gjithë fondin në dispozicion nëse propozimet e dorëzuara nuk i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes.

## Kostot e kualifikueshme

- Zhvillimi dhe testimi i produktit/shërbimit;
- Blerja e pajisjeve (perparesi do të kenë pajisjet që janë energji eficient), licencave apo IT programeve;

## Aplikimi për Grant

Të gjithë aplikantët e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin përkatës së bashku me dokumentacionin e kërkuar në formën PDF, në e-mail adresën [grants@k-w4w.org](mailto:grants@k-w4w.org).

Afati për aplikim është deri më **19 mars 2021**.

Asnjë modifikim i idesë së projektit nuk do të lejohet pasi të ketë skaduar afati i paraqitjes. Sidoqoftë, nëse ka nevojë për të sqaruar aspekte të caktuara ose për korrigjimin e gabimeve, ekipi i menaxhimit të projektit mund të kontaktojë aplikuesin për këtë qëllim.

Pyetje në lidhje me përgatitjen e aplikacionit mund të dërgohet me e-mail deri më **18 mars 2021** në adresën e mëposhtme [grants@k-w4w.org](mailto:grants@k-w4w.org) ose ne tel.045 266 267

## Ankesat e aplikuesve për grante

Aplikuesit e refuzuar mund të parashtrojnë kundërshtim me shkrim brenda pesë ditësh pune nga pranimi i njoftimit për rezultatin. KW4W shqyrton kundërshtimet dhe jep përfundimin me shkrim, i cili i dërgohet aplikuesit ankues brenda pesë ditësh pune nga pranimi i kundërshtimit. Ky përfundim me shkrim nga KW4W është vendimi përfundimtar.

## Kriteret e vlerësimit:

Rezultati i aplikuesve do të jepet në bazë të kriterëve të mëposhtme të përzgjedhjes

	Max
1. Kapaciteti për të menaxhuar grantin	15 pikë
2. Potenciali për të krijuar vende të punës për gratë dhe qëndrueshmëria e tyre (sezonale, afatgjate)	20 pikë
3. Propozimi është relevant me objektivat dhe prioritetet e Grantit	20 pikë
4. Ndikimi mjedisor	10 pikë
5. Mbështetje për minoritetet ose personat me aftësi të kufizuara	5 pikë
6. Kreativiteti ose inovacioni/ Ofrimi i nje produkti/sherbimi te ri ne treg.	10 pikë
7. Planifikimi i biznesit	10 pikë
8. Infrastruktura ekzistuese e biznesit në përputhje me nevojat për implementim të grantit	10 pikë
<b>Pikët Totale:</b>	<b>100 pikë</b>

Vetëm aplikuesit që përzgjedhen do të informohen me shkrim.

## **-Marrëveshja e Grantit**

Kosova -Women 4 Women informon aplikuesit e suksesshëm që janë përzgjedhur për dhënie të grantit brenda 5 ditësh pune nga vendimi i Komisionit. KW4W - harton dokumentacionin e dhënies së grantit, duke përfshirë edhe Marrëveshjen e Grantit.

Aplikuesit e suksesshëm që janë zgjedhur për fitim të grantit janë të obliguar që brenda 5 ditësh pune nga pranimi i njoftimit me shkrim të prezantojnë dokumentet plotësuese siç theksohet:

- Dëshmi që udhëheqësi i idesë/biznesit nuk është nën hetime
- Kopjet e letërnjoftimit për secilin antarë të biznesit.
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit së bashku me informatat mbi pronësinë dhe veprimtarinë e lejuara.
- Certifikatën e numrit fiskal
- Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërin prej bankave të licencuara nga BQK
- Vërtetim që biznesi nuk është në falimentim

Nëse aplikuesi dështon të dorëzojë dokumentet e lartpërmendura brenda pesë (5) ditësh pune nga pranimi i njoftimit me shkrim, aplikimi refuzohet. Fondet e granteve ndahen për kostot e kualifikueshme në bazë të metodës dhe orareve të pagesave sipas përshkrimit në Marrëveshjen e Grantit. Pagesat bëhen me transfertë direkte bankare tek llogaria bankare e fituesit të grantit. Në asnjë rrethanë nuk mund të bëhet pagesa në para, në llogarinë e personit privat, si dhe/ose tek ndonjë llogari jashtë vendit offshore.

## **Mbikëqyrja dhe monitorimi i Granteve nga Kosova – Women 4 Women**

Kjo pjesë përshkruan proceset e përgjithshme të implementimit dhe mbikëqyrjes së granteve të zbatuara nga fituesi i grantit dhe KW4W, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Grantit.

### **Kontrollet financiare/ Raportet financiare:**

Secili fitues i grantit duhet të pranojë dhe do të mbajë një sesion informues për formën e raportimit financiar. Raportimi i parë duhet të bëhet një muaj pas marrjes së grantit, raportimi i dytë pas gjashtë muajve. Faturat origjinale për blerje të paisjeve dhe shërbimeve duhet të dorëzohen tek Kosova – Women 4 Women për verifikim.

### **Monitorimi dhe vlerësimi:**

KW4W përdor mekanizma për të monitoruar performancën e fituesit të grantit, duke përfshirë vlerësimin e rezultateve të aktivitetit, organizimin e vizitave tek aktivitetet e grantit në zbatim e sipër, si dhe shqyrtimin e raporteve periodike. Fituesit e granteve mund të obligohen të raportojnë të dhëna për nevojat e raporteve apo planeve të monitorimit të performancës, siç kërkohet me aktin e dhënies së grantit.